



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE FIER
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Fier, më 03.04.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale per mirembajtjen e kopshteve, shkollave dhe cerdheve ne Bashkinë Fier” (Marrëveshje Kuadër me 1 (një) operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Bojra 44810000-1; Materiale ndërtimi dhe produkte ndihmëse për ndërtimin-44 ; Stuko 44831100-5 ; Gëlqere 44921200-4 ; Mentasha 44523100-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 31 343 583 (tridhjetë e një milion e treqind e dyzet e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2021, 2022**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues eshte ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te përcaktuar se: Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si edhe ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2021, 2022**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **25 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejmë te përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* ne pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* Pika 2/b: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën sic është

parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperm eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 22/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **12 500 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

- a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara
ose
- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e furnizimeve të mëparshme të ngjashme prej 40% të fondit të limit/ vlerës së pritshme të kontratës së parashikuar i jep siguri AK që operatorët ekonomikë kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikate të menaxhimit të cilësive ISO 9001-2015 ose ekuivalente të saj për objektin që prokurohet (*e cila duhet të jetë e perkthyer në shqip dhe e noterizuar*) e lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombëtare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që autoriteti kontraktor të krijojë sigurinë që operatorët ekonomikë ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të përmbushur me sukses kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatën e menaxhimit të cilësive që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për objektin e prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Certifikata për menaxhimin e cilësive ISO 9001 është referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësive të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë

permasave. Ky kriter kerkohet nga AK sepse garanton se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për produktet e ofruara dhe zbatimin e kontratës sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Sjellje në vëmendje: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur në bazë të kërkesës nr.3/4 prot, datë 15.02.2023, protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.2265 prot, datë 13.03.2023 dhe dokumentacionit bashkelidhur saj si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të Nderrmarrjes së Sherbimeve Publike Fier, me urdher nr.3 prot. Date 10/2/2023 percjelle me shkresën nr.3/4 prot, datë 15.02.2023, të Nderrmarrjes së Sherbimeve Publike Fier, protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.2265 prot, datë 13.03.2023, bashkengjitur DST në SPE.

Shenim : *Ne çdo rast kur në specifikimet teknike dhe preventive mund të jete përdorur si reference emri i ndonjë marke apo emri të vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.*

Ne specifikimet teknike dhe preventive i cili gjendet bashkelidhur DST në SPE, ku është përdorur fjala “Importi”, “Cilesi e Pare” » ... shtohet termi « ose ekuivalent i saj »

Njësia e prokurimit: